

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E ARSIMIT
 DHE SPORTIT
 QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

MODEL TESTI I MATURËS SHTETËRORE PROFESIONALE 2025

KUALIFIKIMI PROFESIONAL "BUJQËSI"

Udhëzime për maturantin/kandidatin

Testi përmban gjithsej **60 pikë**.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Testi ka **20 pyetje me zgjedhje (alternativa)** dhe pyetjet e tjera janë me zhvillim.

Pikët për secilën pyetje janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7	8
Pikët								
Kërkesa	9	10	11	12	13	14	15	16
Pikët								
Kërkesa	17	18	19	20	21	22	23	24
Pikët								
Kërkesa	25	26	27	28	29	30		
Pikët								

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

1. Bashkësia e formuar nga organizma të gjallë dhe mjedisit jo të gjallë quhet: **1 pikë**
- A) Agroekosistem;
B) Agrosistem;
C) Biodiversitet;
D) Ekosistem;
2. Lënda organike në bimë zërthehet nga procesi i: **1 pikë**
- A) frymëmarrjes;
B) fotosintezës;
C) fotoperiodizmit;
D) vernalizimit;
3. Cila pjesë e qelizës bimore ndodhet brenda membranës dhe që përmban një sërë organelesh të rëndësishëm në funksionimin e qelizës? **1 pikë**
- A) Muri qelizor;
B) Membrana;
C) Citoplazma;
D) Bërthama qelizore;
4. Shuma e të gjitha ndryshimeve që ndodhin në një organizëm gjatë ciklit të tij vegjetativ quhet: **1 pikë**
- A) Rritje;
B) Shumim;
C) Zhvillim;
D) Ripërtitje;
5. Sipas pikëpamjes gjenetike, fara është: **1 pikë**
- A) organizëm i gjallë që përfaqëson bimën e ardhshme në miniaturë;
B) mbartëse dhe transmetuese e materialit gjenetik;
C) përfaqësuese e materialit mbjellës të kulturave;
D) mall që shitet e blihet dhe përbën një objekt biznesi;
6. Fryrje ose të dala të indeve meristemmatike dhe përçuese, që formohen rreth qafës së rrënjës, dalin në trungje e degë quhen: **1 pikë**
- A) Lastunja;
B) Thithakë;
C) Gunga;
D) Këmbëza;
7. Pjesa e ujit tokësor që rrethon grimcat e tokës dhe mbahet nga forcat e adezionit (bashkëveprimi) quhet ujë: **1 pikë**
- A) Nëntokësor;
B) Kapilar;
C) i rëndësës;
D) higroskopik;

8. Cili nga makroelementët e mëposhtëm ka si funksion bazë të tij, ndërtimin e proteinave dhe aminoacideve?
1 pikë
- A) Azoti;
 - B) Fosfori;
 - C) Potasi;
 - D) Kalciumi;
9. Aftësia e tokës për të neutralizuar acidet, bazat, kripërat bazike ose acide që mund të përdoren ose mund të formohen në tokë quhet:
1 pikë
- A) Aciditet;
 - B) Bazicitet;
 - C) Buferitet;
 - D) Tretësirë;
10. Kapaciteti i plotë i tokës për ujë (Kp) shpreh sasinë:
1 pikë
- A) maksimale të ujit që mund të mbajë toka;
 - B) e lagështirës që ndodhet midis kapacitetit fushor të tokës dhe pikës së vyshkjes;
 - C) e ujit që mbetet në tokë, pasi largohet uji i rëndesës;
 - D) e ujit tokësor që nuk shfrytëzohet nga bimët;
11. Sistemi i bujqësisë që prodhon me synimin e vetëm shëndetësimin e vazhdueshëm të tokës, ekosistemeve dhe njerëzve quhet sistemi i bujqësisë:
1 pikë
- A) së zakonshme;
 - B) së integruar;
 - C) intensive;
 - D) organike;
12. Në mbrojtjen e integruar në bujqësinë organike, faza e përcaktimit të stadiit fenologjik të bimës dhe të parazitit quhet:
1 pikë
- A) Diagnozë;
 - B) Verifikim mjedisor;
 - C) Ndërhyrje;
 - D) Integrim dhe planifikim i ndërhyrjeve;
13. Në blegtori, sistemi i prodhimit që përmirëson cilësinë e mjedisit e të burimeve të tij, sjell produkte të mjaftueshme ekonomikisht të pranueshme për konsumatorët dhe përmirëson cilësinë e jetës së mbarështuesve quhet mbarështim:
1 pikë
- A) Intensiv i blegtorisë;
 - B) Organik i blegtorisë;
 - C) I zakonshëm i blegtorisë;
 - D) I integruar i blegtorisë;
14. Në sistemin e mbarështimit organik, krijimi i mundësive, kafshëve, për të zhvilluar e shprehur në mënyrë plotë sjelljen e tyre specifike, në raport me kategoritë e tjera të kafshëve të të njëjtit lloj quhet mirëqenie:
1 pikë
- A) Fiziologjike;
 - B) Ekologjike;
 - C) Etiologjike;
 - D) Biologjike;

15. Në periudhën e certifikimit të fermave organike, procedura e kontrollit dhe verifikimit të kushteve të prodhimit organik të përcaktuara në ligj quhet:

1 pikë

- A) Certifikim;
- B) Inspektim;
- C) Etiketim;
- D) Notifikim;

16. Marrja e vendimit për të blerë tokë bujqësore fillon me përcaktimin e vlerës së saj. Cila nga alternativat e mëposhtme është treguesi më i rëndësishëm në përcaktimin e vlerës së tokës?

1 pikë

- A) Afërsia me tregjet;
- B) Lloji i tokës;
- C) Potenciali i të ardhurave;
- D) Zona ose rajoni;

17. Cili Kontabilitet grumbullon informacion dhe e përpunon atë, për nevojat e drejtuesve të fermës për vendimmarrje strategjike:

1 pikë

- A) Kontabiliteti i aplikuar;
- B) Kontabiliteti i drejtimit;
- C) Kontabiliteti i kostos;
- D) Kontabiliteti financiar;

18. Gjatë një periudhe të caktuar fitimi bruto i fermës është 550 000 lekë. Duke ditur që shpenzimet operative janë 200 000 lekë dhe shpenzimet e interesit janë 50 000 lekë. Sa do të jetë fitimi neto i fermës?

1 pikë

- A) 300 000 lekë;
- B) 250 000 lekë;
- C) 200 000 lekë;
- D) 150 000 lekë;

19. Cila kontratë ka si objekt kalimin e pronësisë së një sendi ose kalimin e një të drejte kundrejt pagimit të një çmimi?

1 pikë

- A) Kontrata e qirasë;
- B) Kontrata e sipërmarrjes;
- C) Kontrata e dhurimit;
- D) Kontrata e shitjes;

20. Vlera me të cilën një fermë shet produktet bujqësore të saj është 200 000 lekë. Sa do të ishte vlera e faturës bashkë me TVSH-në?

1 pikë

- A) 240 000 lekë;
- B) 260 000 lekë;
- C) 280 000 lekë;
- D) 300 000 lekë;

21. Shkruani saktë 4 (katër) përkufizimet e koncepteve të mëposhtëm.

4 pikë

Vernalizim quhet _____

Frymëmarrje quhet _____

Fotosintezë quhet _____

Fotoperiodizëm quhet _____

22. Listo 4 (katër) zonat e rrënjës në prerjen gjatësore të saj.

4 pikë

1) _____

2) _____

3) _____

4) _____

23. Shkruaj saktë emrin e organelit të qelizës bimore në vendin bosh në fjalitë e mëposhtme:

4 pikë

1) _____ shërben për ruajtjen, ndryshimin dhe sekretimin e proteinave apo enzimave.

2) _____ shërben për kapjen e dritës së diellit gjatë procesit të fotosintezës.

3) _____ shërben për zbërthimin e karbohidrateve dhe realizimin e frymëmarrjes.

4) _____ shërben për grumbullimin e amidonit.

24. Cilët janë 4 (katër) nga veprimtaritë bujqësore që ndikojnë negativisht në ekosistem:

4 pikë

1) _____

2) _____

3) _____

4) _____

25. Listoni 4 (katër) nga epërsitë kryesore të metodës së integruar të zbatuar në mbrojtjen e kulturave bujqësore. **4 pikë**

- 1) _____
- 2) _____
- 3) _____
- 4) _____

26. Listoni 4 (katër) nga mënyrat e ujitjes me rrjedhje të lirë. **4 pikë**

- 1) _____
- 2) _____
- 3) _____
- 4) _____

27. Listo 4 (katër) elementët përbërës të rrjetit kullues të tokës bujqësore? **4 pikë**

- 1) _____
- 2) _____
- 3) _____
- 4) _____

28. Shkruaj 4 (katër) nga hapat e procedurës së aplikimit të fermerit për të kaluar nga fermë e zakonshme në BIO. **4 pikë**

- 1) _____

- 2) _____

- 3) _____

- 4) _____

29. Cilët janë elementët që përbëjnë aktivin qarkullues të bilancit të fermës?

4 pikë

- 1) _____
- 2) _____
- 3) _____
- 4) _____

30. Listoni 4 (katër) prej strategjive që mund të ndiqen për të orientuar më mirë shitjet e produkteve bujqësore dhe për të fituar besnikërinë e konsumatorëve:

4 pikë

- 1) _____
- 2) _____
- 3) _____
- 4) _____

